<sup>3</sup> Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 11

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1:

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 11).

### 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të çertifikuara të bilanceve, të tre viteve të mëparshme (2017, 2018, 2019) të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), si dhe të shoqëruara me Akt – Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të autorizuar.

2.2.2 Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, lëshuar nga administrata tatimore, ku të vërtetohet se xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më e vogël se 90 % e fondit limit që prokurohet.

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.**

2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2018 dhe 2019 për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

## 2.3 Për kapacitetin teknik:

### 2.3.1 Përvojë e sukseshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** (që i korrespondon vlerës 4 914 196 lekë) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve te fundit.  
ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** (që i korrespondon vlerës 19 656 784 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :
  - i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8*
- Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
  - i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8*
  - vi. Leje shfrytëzimi/ përdorimi*
  - vii. Leje ndërtimi*

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zërat kryesore të punimeve kanë volume të konsiderueshme krahasimore të përcaktuara në këtë prokurim.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit.



Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë Liçencën e shoqërisë, e nevojshme për zbatimin e kontratës, Për këtë duhet të paraqesin liçencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”. Liçensa profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI:

▪ **Liçense profesionale e shoqërisë e vlefshme në kategoritë:**

- **Kategoria NP-4** (*Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale*) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*) – **Klasifikimi A**

\* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

**2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **OHSAS 18001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose **ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar
- **ISO 39001** (*Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor*) e përditësuar

ISO-t e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesi **dëshmi nga administrata tatimore** (Drejtoria Rajonale e tatim taksave) për punësimin mesatar jo më pak se **30 (tridhjetë) punonjës** për periudhën **Gusht 2019 – Gusht 2020**, ku përfshihet edhe Drejtuesi Teknik.

**a) Të paraqiten:**

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Korrik 2019 – Korrik 2020**

2. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2019 – Korrik 2020**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- b) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për 6 (*gjashtë*) muajt e fundit, stafi inxhinierik si më poshtë:
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
  - Minimuni **1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder**
  - Minimuni **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- c) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknk (të vlefshme), të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara për çertifikimin e punonjësve sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (*indryshuar*), të paktën punonjës me specialitetin si më poshtë:
- Teknik ndërtimi - jo më pak se **2 (një)** punonjës
  - Saldator – jo më pak se **1 (një)** punonjës
  - Mekanik – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- \* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë/ diplomë që dëshmon aftësitë profesionale të punonjësit lëshuar nga një institucion i akredituar, Kartelat përkatëse të kualifikimit të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (*tre*) muajt e fundit.
- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën **3 (tre)** manovratorë, **1 (një)** automakinist dhe **6 (gjashtë)** shoferë, për të cilët të paraqiten dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) të lëshuar nga institucioni përkatës, kontrata e punës e vlefshme si dhe figurojë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (*tre*) muajt e fundit.
- e) Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një Inxhinier që përmbush kriteret për të qënë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë/ dëshmi trajnimi (*Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2020 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-së nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, të shoqëruar me kontratë pune noteriale (të vlefshme), Librezë pune, Diplomë, CV si dhe të figurojë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë të paktën për 3 (*tre*) muajt e fundit
- f) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qënë “*Ekspert për Ndhimën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

**Emergjencave** ” si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikatë/ dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

- g) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera gjatë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Librezë pune (përkatëse)
  - b) CV përkatëse
  - c) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
  - d) Diplomë

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencë të vlefshme për transportim të mbetjeve inerte dhe dhera, Kodi III.2.B, lëshuar nga Organet përkatëse të Liçensimit.

### 2.3.6 (Makineri, Pajisje)

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës (15 – 20 ton)	<i>jo më pak se</i> <b>2 copë</b>
2.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti total mbajtës mbi 20 ton	<i>jo më pak se</i> <b>2 copë</b>
3.	Kamioncine me kapacitet mbajtës (1 – 3 ton)	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
4.	Kamion me Vinç	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
5.	Fadrome me goma	<i>jo më pak se</i> <b>2 copë</b>
6.	Autobot uji	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
7.	Minieskavator me zinxhir gome	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
8.	Rrul me vibrim mbi 12 ton	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
9.	Rrul me kompresor mbi 8 ton	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
10.	Rrul deri 3 ton	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
11.	Asfaltoshtruese	<i>jo më pak se</i> <b>2 copë</b>
12.	Skarifikuese ( <i>Frezë Asfalti</i> )	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
13.	Autobitumatriçe	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
14.	Makineri fshesë rruge	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>
15.	Kompresor	<i>jo më pak se</i> <b>1 copë</b>

Dokumenta Standarde të Tenderit

16.	Gjenerator	<i>jo më pak se 2 copë</i>
17.	Matrapik	<i>jo më pak se 2 copë</i>
18.	Saldatrice	<i>jo më pak se 1 copë</i>

- b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – *jo më pak se 30 copë*
  - Jelekë Fosforeshente – *jo më pak se 30 copë*
  - Doreza pune – *jo më pak se 30 copë*
  - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 10 copë*
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 20 copë*
  - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – *jo më pak se 5 copë*

**□ Për vërtetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Çertifikatën e transportit nga autoritetet përkatëse për vete dhe të tretë (*të vlefshme*) dhe Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat (*të paktën 2*).
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Çertifikatën e transportit nga autoritetet përkatëse për vete dhe të tretë (*të vlefshme*) dhe Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat (*të paktën 2*).
- 3- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 4- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

**Shënim:** *Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira, të paraqiten: 1. Kontratë noteriale qiraje/ huapërdorje me emër objekti dhe me afate të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve dhe/ ose; 2. Kontrate noteriale qiraje/ huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht dhe mandat pagesat bankare për secilin nga automjetet dhe/ ose pajisjet e marra me qira.*

- 5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i ketë kapacitetet teknike të angazhuara në kontratat të tjera, nuk duhet të jenë të deklarurara në procedurë të shpallura fituese dhe/ose në procedurë të cilat kanë lidhje me procedurat e rindërtimit të objekteve të dëmtuara si pasojë e termetit të 26 Nëntor

2019, si dhe të deklarojë vendodhjen e mjeteve, pajisjeve për verifikim nga KVO-ja gjatë vlerësimit (**deklaratë me shkrim nga Administratori i Shoqërisë**)

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.*

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) fabrikë për prodhimin e asfaltit në pronësi ose me qera ose huapërdorje/ ose të lidhur kontratë furnizimi/ (Kontrata Noteriale e Qerasë/ huapërdorjes/ furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*kontrata e blerjes apo ç'doganimit dhe fatura tatimore përkatëse*), foto dhe kontratën noteriale të qerasë/huapërdorjes/ furnizimit në rast se fabrika është me qera/ huapërdorje ose me kontratë furnizimi.
- Leje Mjedisi nga QKL, (Kodi III.1.B)

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) Linjë e prodhimit të prajmerit në pronësi ose me qera ose huapërdorje/ ose të lidhur kontratë furnizimi/ (Kontrata Noteriale e Qerasë/ huapërdorjes/ furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*kontrata e blerjes apo ç'doganimit dhe fatura tatimore përkatëse*), foto dhe kontratën noteriale të qerasë/huapërdorjes/ furnizimit në rast se fabrika është me qera/ huapërdorje ose me kontratë furnizimi.
- Leje Mjedisi nga QKL, (Kodi III.1.B)

### **2.3.9 Afati i kryerjes së punimeve:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit, në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

**2.3.10** Në zbatim të nenit 26 të VKM 914 datë 29.12.2014 (të ndryshuar) **OE/BO duhet të paraqesë:** *Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala "periudhë" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/ investimit.*

### **❖ SHËNIME:**

- I.** Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës oferton/ merr pjesë si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, kandidatët/ ofertuesit duhet t'i përmbahen përcaktimeve të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kandidatët/

ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 e 46 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

**II. Për të mundësuar njohjen me terrenin dhe objektin ku do të realizohen punimet objekt prokurimi, nëse kërkohet nga Op. Ek. që të kryej një vizitë, Autoriteti Kontraktor do të organizojë një vizitë në terren në datën që do të caktohet me marrëveshje, duke vënë në dispozicion të Op. Ekonomik punonjës të Bashkisë Mat, që do të shoqërojnë të interesuarit për këtë qëllim.**

*\* Për të gjithë Op. Ekonomik ofertues pjesmarrës në procedurën e prokurimit, të cilët nuk kanë kërkuar vizitë, në rast se shpallen fitues dhe gjatë kohës së realizimit të kontratës, paraqesin pretendime që lidhen me terrenin, këto pretendime nuk do të merren në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor.*

- Logjistika dhe shpenzimet e vizitës në objekt do të mbulohen nga Operatori Ekonomik.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.**

## Shtojca 12

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF**

Specifikimet Teknike të Materialeve: **sipas materialeve bashkëngjitur në formatin PDF**

Grafiku i Punimeve: **afati për kryerjen e punimeve është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **sipas materialit bashkëlidhur në PDF**

**Shtojca 13**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

- **Sipas materialit bashkëngjitur në formatin PDF.**



**Shtojca 14.**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 17

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i



materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

#### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

- 13.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujën dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në

